



QENDRA PËR ZHVILLIM TË RAJONIT PLANOR JUGPERËNDIMOR

RAPORT VJETOR
Për realizimin e Programit për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor
Për vitin 2019

Janar 2020

HYRJE

Programi për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor është dokument bazik afatmesëm, i cili bazën e vet juridike e ka në Ligjin për zhvillim të barabartë rajonal (nenet 12-14), i përgatitur me qëllim që të zvogëlohen disparitetet në mes rajoneve planore, si dhe në vetë rajonin, dhe të sigurohet zhvillim i qëndrueshëm përmes shfrytëzimit të potencialeve të disponueshme të përgjithshme.

Operacionalizimi i Programit në nivel vjetor kryhet përmes Planit aksionar realizimi i të cilit është bazë për realizimin e qëllimeve dhe prioriteteve të përcaktuara në Programin për zhvillim të rajonit planor, përkatësisht në zhvillimin ekonomik, infrastrukturor, rural, turizëm dhe kulturë, si dhe ai arsimor dhe social dhe aspektet e tjera të zhvillimit të RPJP.

Qendra për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor në pajtim me detyrimet ligjore, dhe duke i respektuar praktikat e transparencës së punës, e përgatit këtë Raport Vjetor për realizimin e programit për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor për vitin 2019.

Në Raport, projektet dhe aktivitetet drejtpërdrejtë janë të ndërlidhura me Qëllimet afatmesme, prioritetet dhe masat nga Programi për zhvillim, si dhe me treguesit për shkallën e realizimit të këtij dokumenti bazik në vitin rrjedhës. Raporti vjetor është i konceptuar në katër pjesë me çka çdo pjesë përmban aktivitete të realizuara të projektit në pajtim me qëllimet afatmesme.

Në Raportin vjetor përveç pjesës narrative janë vendosur edhe detalisht edhe qëllimet afatmesme përkatëse, prioritetet, masat, treguesit dhe rezultatet dalëse, si dhe përmbledhja e tyre tabelare.

Vlen të theksohet se aktivitetet e prezantuara në pjesë më të madhe janë realizuar nga Qendra për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor, por gjithashtu edhe nga ana e komunave në kuadër të rajonit planor Jugperëndimor.

Pjesa më e madhe e aktiviteteve janë financuar përmes Programeve për zhvillim të barabartë rajonal të Ministrisë për vetëqeverisje lokale dhe Byrosë për zhvillim rajonal, Agjencia Zvicerane për zhvillim dhe bashkëpunim (SDC) bashkë me Ministrinë për vetëqeverisje lokale përmes projektit “Zhvillim i barabartë rajonal i qëndrueshëm dhe inkluziv”, Programit për zhvillim rural të Agjencionit për përkrahje të bujqësisë dhe zhvillimit rural, si dhe nga donatorë të jashtëm BE, UNDP dhe të tjerë.

Të gjithë aktorët bashkërisht kontribuojnë në realizimin e programit për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor dhe me atë japin kontribut të rëndësishëm për zhvillimin e rajonit dhe përmirësimin e kushteve për jetesë të qytetarëve.

Qëllimi afatmesëm 1

Ekonomi moderne rajonale e bazuar në teknologji dhe njohuri të larta

1. Identifikimi dhe realizimi i projektit nga Strategjia për inovacione të RPJP

Në kuadër të Shemës së granteve për projekte inovative përmes projektit “Zhvillim i barabartë rajonal i qëndrueshëm dhe inkluziv” i cili financohet nga Agjencia zvicerane për zhvillim dhe bashkëpunim dhe Ministria e vetëqeverisjes lokale, u identifikua dhe u realizua projekt inovativ në pajtim me Strategjinë për inovacionet të RPJP.

Në pajtim me rregullat dhe kriteret të dhëna nga donatori, Qendra për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor, në periudhën nga shkurti deri në prill 2019 i realizoi të dyja punëtoritë konsultative për identifikimin dhe përgatitjen e propozim projektit inovativ. Në punëtorinë e parë konsultative pjesëmarrësit nga Rajoni gjeneruan ide për projekte për pilot projekt inovativ, dhe nga më shumë propozime u përzgjedhën tre ide për zhvillimin e koncepteve nga ana e grupeve punuese, të përbëra nga përfaqësues të zyrave ZHEL nga 9 komunat e rajonit, nga OJQ dhe Biznes sektori dhe nga akademia. Në punëtorinë e dytë të tri grupet punuese bënë prezantimin e projekt koncepteve të përgatitura. Konceptet e përgatitura u dorëzuan deri te Ministria e vetëqeverisjes lokale kah fundi i prillit të vitit 2019. Pas marrjes së vendimit nga Komisioni për vlerësim, Qendra përgatiti aplikacion të plotë për konceptin e përzgjedhur “Vizuelizimi i atraksioneve turistike në rajonin planor Jugperëndimor”, dhe të njëjtin e dorëzoi tek Donatori. Pas nënshkrimit të Marrëveshjes, Qendra filloi me realizimin e pilot projektit.

Masa 1.1.2 Rritja e kapaciteteve inovative të ndërmarrjeve nga Rajoni

Treguesit

- Numri i aktiviteteve të realizuara për rritjen e kapaciteteve për inovacion

Rezultatet dalëse

- Organizimi i dy punëtorive konsultative me 30 pjesëmarrës nga rajoni
- Organizimi i 4 takimeve me grupe punuese
- Gjenerimi dhe përgatitja e 3 koncepteve për projekte inovative
- Për konceptin e përzgjedhur përgatitet aplikacioni i plotë dhe e dorëzuar deri te donatori

2. Përhkrahje të Qendrës për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor përmes projektit “Zhvillim i barabartë rajonal i qëndrueshëm dhe inkluziv”

Në kuadër të projektit “Zhvillim i barabartë rajonal i qëndrueshëm dhe inkluziv”, u nënshkrua Marrëveshje për përkrahje financiare të Qendrës, për realizimin e Konferencës rajonale, Forumeve rajonale dhe përgatitja e Programit për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor për periudhën e ardhëshme pesëvjeçare.

2a. Organizimi i konferencës rajonale për shkëmbimin e praktikave të mira në zhvillimin rajonal

Faza përgatitore filloi me përgatitjen e konceptit të konferencës i cili u miratua nga Njësia projektuese. Pas miratimit u bë furnizimi për organizimin e konferencës në pajtim me rregullat Zvicerane. Konferenca dy ditore u mbajt nga 27 deri në 28 qershor 2019 në Strugë. Në Konferencë morën pjesë 75 pjesëmarrës nga rajoni, përfaqësues të komunave, biznes sektori, sektori joqeveritar dhe institucionet arsimore. Në ditën e parë të konferencës u punua në seancë plenare dhe u shqyrtuan tre tema: Zhvillimi i barabartë rajonal gjatë 10 viteve të fundit, Ligji për ZHBR dhe 1% e PBB, dhe Zhvillimi i qëndrueshëm. Në ditën e dytë pjesëmarrësit u ndanë në tri grupe në sferat tematike: Infrastruktura dhe ambienti jetësor në zhvillimin rajonal, Zhvillimi rural dhe shfrytëzimi i fondeve të BE-së, dhe Turizmi dhe zhvillimi i barabatë rajonal. Pjesa përfundimtare e konferencës ishte plenare ku u prezantuan rezultatet nga grupet punuese e të trija temave. Për konferencënu angazhua Moderator dhe 8 ekspertë (profesorë universitar) për çdo bllok tematik. Nga të gjitha prezantimet në konferencë u përgatit dhe u botua përmbledhja në tri gjuhë Maqedone, Shqipe dhe Angleze.

2b. Organizimi i forumeve rajonale për identifikimin e projekt ideve

U organizuan 3 forume rajonale për identifikimin e projekt ideve gjatë periudhës shkurt-mars të vitit 2019. Në forume morën pjesë 80 përfaqësues nga komunat, sektori joqeveritar dhe ai i biznesit dhe akademia. Nga idetë e propozuara u përgatitën 3 projekt koncepte, nga të cilat Komisioni për

vlerësim e përzgjedhi “Rregullimi i zonave dhe rrugëve atraktive në rajonin planor Jugperëndimor”. Për këtë koncept u përgatit aplikacioni i plotë dhe i njëjti u miratua për financim përmes Shemës së granteve për projekte investive.

2c. Përgatitja e Programit për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor për periudhën 2020-2024

Qendra për zhvillim përgatiti koncept për përpunimin e Programit për zhvillim, në pajtim me Metodologjinë për përgatitjen e dokumenteve planore. Koncepti u miratua nga Njësia projektuese, dhe mjetet për përgatitjen e Programit u bartën në llogarinë e projektit. Sipas udhëzimeve të Ministrisë për vetëqeverisje lokale dhe Njesisë Projektuese, përgatitja e Programit nuk filloi deri në fund të vitit 2019, sepse deri tani nuk është përgatitur Strategjia e re për zhvillim të barabartë rajonal.

Masa 1.1.3 Rritja e kapaciteteve të palëve të interesuara për qasje deri tek fondet përkatëse në nivel shtetëror dhe BE

Treguesit

- Numri i aktiviteteve të realizuara për rritjen e kapaciteteve qasëse

Rezultatet dalëse

- U organizua Konferencë dy ditore me 75 përfaqësues nga rajoni
- U prezantuan 12 prezantime para pjesëmarrësve nga sfera e zhvillimit rajonal
- U përgatit dhe u botua Përmbledhja nga konferenca në 3 gjuhë në 100 kopje
- U realizuan 3 furnizime publike për konferencën, forumet dhe moderatorin në pajtim me rregullat e Zvicranëve
- U organizuan 3 forume për identifikimin e projekt ideve për Shemën e granteve për projekt investues
- U organizuan 3 takime me grupe punuese për përgatitjen e koncepteve
- U përgatitën 3 koncepte me propozim projekte për Shemën e granteve për investime
- U përgatit një aplikacion i plotë për konceptin e përzgjedhur për Shemën e granteve
- U përgatit koncepti me plan financiar për përgatitjen e Programit për zhvillim të RPJP

3. Përmirësimi i qeverisjes lokale

Ky projekt financohet nga UNDP përmes projektit “Përmirësimi i qeverisjes komunale”. Për tre komuna rurale nga Rajoni – Vevçani, Debërc dhe Qendër Zhupë, janë përgatitur Plane të integruara për zhvillim lokal. Gjithashtu për secilën komunë u dha mundësia të realizojnë nga një pilot projekt nga Plani i integruar për zhvillim lokal. Ashtu në Vevçan është realizuar pilot projekt për furnizimin të traktorit me pajisje plotësuese për pastrimin e borës dhe mirëmbajtjes së hapsëriave të gjelbra. Në Debërc u përgatit LEAP dhe janë furnizuar 350 shporta për mbeturina me kapacitet prej 360 l. Në Qendër Zhupë është furnizuar traktor multifunksional për nevojat e komunës për pastrimin e rrugëve, borës, degëve, hapjen e gropave dhe tjera.

Masa 1.1.3 Rritja e kapaciteteve të palëve të interesuara për qasje deri tek fondet përkatëse në nivel shtetëror dhe BE

Treguesit

- Numri i aktiviteteve të realizuara për rritjen e kapaciteteve për qasje

Rezultatet dalëse

- 3 punëtori të organizuara me përfaqësues nga 3 komuna rurale për përgatitjen e Planeve të integruara për zhvillim lokal
- 3 Plane të integruara të përgatitura për zhvillim lokal në tre komuna
- U përgatit PAEL për Komunën e Debërcës
- Furnizimi i 2 traktorëve multifunksional në Vevçan dhe Qendër Zhupë
- Furnizimi i 350 shportave për mbeturina nga 360 l në Komunën e Debërcës

4. Biznes Qendra për përkrahje dhe shërbime të biznes sektorit

Në kuadër të aktiviteteve të Biznes qendrës pranë Qendrës për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor, u realizua ripërtëritja dhe korrigjimi i bazës ekzistuese me kontakt informacione me ndërmarrjet e vogla dhe të mesme rajonale, si dhe vendosja në të edhe bujqit e regjistruar. Të dhënat u morën nga adresari dixhital “Libri i artë”, nga njësitë rajonale të Ministrisë së bujqësisë pylltarisë dhe ujërave, nga Komunitat (atje ku kishte evidencë) dhe nga baza e Odës ekonomike rajonale pranë Odës ekonomike të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Në atë mënyrë, me analizën e disa burimeve relevante kemi bazë të qartë të komunikimit.

Në të njëjtën kohë me azhurnimin e të dhënave kontaktuese, filloi edhe përgatitja e realizimit të anketës, me çka u selektuan disa zona të cilët duhej ta definojnë pyetësin, ta përcaktojnë kornizën në të cilën do të vendosen çështje konkrete. Qëllimi i anketës është të sigurohen të dhëna për nevojat e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe bujqve, me qëllim të përcaktimit të llojit të trajnimeve ose mentorimeve të cilat janë të nevojshme për zhvillimin e biznesit të tyre.

Gjatë muajit Tetor 2019 filloi të realizohet anketa, në fillim vetëm në formë dixhitale – përmes adresës elektronike, por për shkak të interesit të ulët kaluam në anketimin klasik në terren dhe me telefon. Anketa mbaroi gjatë javës së parë të nëntorit dhe deri në mesin e muajit u përfundua edhe analiza e së njëjtës.

Në periudhën raportuese subjektet juridike të interesuara nga Rajoni ju prezantuan mundësitë e financimit përmes Programit të Qeverisë së RMV-së për konkurrencë, ndërmarrësi dhe inovacione për vitin 2019, e dedikuar para së gjithash, për nxitjen e ndërmarrësisë, si dhe përmes shpalljeve të Ministrisë së ekonomisë për nxitjen e turizmit fshatar.

Sektorit të NVM rregullisht i dorëzohen informacione relevante për thirrje në kuadër të BE-së, para së gjithash, Për Programet Horizon 2020 dhe COSME.

Me procedurë elektronike, përfaqësuesit e sektorit të NVM, odat ekonomike, asociacionet dhe prodhuesit, rregullisht u informuan dhe i ftuan në eventet që i organizonte Qendra për zhvillim të RPJP, si dhe nga ana e institucioneve tjera në nivel nacional, rajonal dhe lokal, dhe të cilat kishin të bëjnë me tema në interes të biznes sektorit.

Masa 1.3.3 Shfrytëzimi i programeve për financim në sektorin e NVM

Treguesit

- Numri i aktiviteteve të realizuara për nxitjen e zhvillimit ekonomik në rajon

Rezultatet dalëse

- Tre takime informative të organizuara për 60 përfaqësues të biznes sektorit në rajonin planor Jugperëndimor

- Bazë rajonale elektronike e azhurnuar për institucione dhe kompani të cilat ofrojnë shërbime për zhvillim të sektorit privat

- Bazë rajonale e zgjeruar me bujq

- U përgatit Anketë për nevojat e biznes sektorit

- U realizua anketë me 130 anketues

- U përgatit Analizë për nevojat e biznes sektorit për trajnime

- Informim i rregullt i biznes sektorit përmes postës elektronike

- U përgatitën katër raporte kuartale për periudhën e realizimit të aktiviteteve projektuese dhe u dorëzuan deri te MVL

5. Ndërtimi dhe rikonstruktimi i rrugëve lokale në rajonin planor Jugperëndimor

Projekti financohet përmes Programeve për përkrahje financiare të zhvillimit rural për vitin 2018 përmes masës 321 Përmirësimi i kualitetit të jetës në zonat rurale, nën masa 321.1 Investime në infrastrukturën lokale (duke përfshirë edhe ura) për lidhjen e dy ose më tepër vendbanimeve në zonat rurale me gjatësi prej 5 km. Me Agjencinë për përkrahje financiare të bujqësisë dhe zhvillimit rural (APFBZHR) u nënshkrua Vendim për miratimin e kërkesës për përkrahje financiare në mesin e muajit Qershor 2019. Dokumentacioni tenderik dhe Marrëveshjet me operatorët ekonomik u dorëzuan deri te Agjencia (APFBZHR) me qëllim që të merret Vendimi përfundimtar dhe Marrëveshja për realizim të aktiviteteve të projektit. Deri në fund të vitit 2019 Marrëveshje me APFBZHR nuk u nënshkrua dhe për atë shkak punët ndërtimore në terren nuk filluan. Vlen të theksohet se me APFBZHR janë bërë pajtueshmëri për aktivitetet që do të realizohen gjatë rikonstruktimit dhe ndërtimit të rrugëve vijuese: Arbinovë-Laktinjë (Komuna e Debrëcës), Tomino-Sushica (Makedonski Brod), dhe Morovisht-Volinë (Komuna e Strugës).

Masa 1.4.2 Krijimi i kushteve për zhvillim rural

Treguesit

- Numri i aktiviteteve të realizuara për ndërtimin e strukturave funksionale-hapësinore

Rezultatet dalëse

- U përgatitën 4 specifikime për furnizim publik
- U realizuan 2 furnizime publike për ndërtimin e rrugëve (në tri pjesë) dhe për mbikëqyrje
- U nënshkruan dy marrëveshje me operatorë ekonomik për ndërtim dhe mbikëqyrje
- U mbajtën 3 takime për harmonizimin e dokumentacionit projektues me APFBZHR

6. Përmirësimi i infrastrukturës rrugore në RPJP përmes përgatitjes së dokumentacioni teknik

Ky projekt është i financuar përmes Programeve për zhvillim të barabartë rajonal për vitin 2019. Në Listën vjetore me propozim projektet rajonale për vitin 2019 projekti ishte i rradhitur në vend të tretë, dhe për ato shkaqe nga gjithsej mjetet e kërkuara u miratuan vetëm 40%. Për ato shkaqe pritej të mbarojnë të gjitha furnizimet publike nga projekti rajonal i parë dhe i dytë, që të shihet se sa mjete do të kursehen dhe të njëjtat të ridestinohen për projektin e tretë. Furnizimi publik për shërbime për projektim është realizuar në tetor të vitit 2019 kur me mjetet e kursyera janë siguruar 62% nga mjetet e kërkuara. Për ato shkaqe nuk mund të përgatitej dokumentacion teknik për të gjitha rrugicat që ishin të përmendura në aplikacionin projektues. Deri në fund të vitit 2019 filloi përgatitja e dokumentacionit teknik për rrugicat vijuese: Ohër-kisha Shën Athanasi (1460 m), rruga në f.Volinë – Debërc (1000 m), rrugë në f.Banisht-Dibër (950 m), krah i rr.8 Shtatori në Dibër (600 m), rr.Shopov Most- Shtëpia e shëndetit në Vevçan (50 m), rruga “Turistike” në Strugë (3500 m). Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë Projekt infrastrukturor dhe themelor me revizion, elaborate gjeodezike, elaborate për ndikimin mbi ambientin jetësor dhe dokumente tjera përcjellëse.

Masa 1.5.1 Ndërtimi, rikonstruktimi dhe modernizimi i rrjetit rrugor

Treguesit

- Numri i aktiviteteve të realizuara

Rezultatet dalëse

- Specifikacione teknike të përgatitura për 6 rrugë
- Dokumentacioni tenderik i përgatitur

- Furnizim publik i realizuar për shërbime për projektim dhe Marrëveshje e nënshkruar me operatorin ekonomik

7. Rikonstruktimi i rrjetit rrugor aktual dhe të ri në RPJP

Me projektin është bërë përmirësimi i infrastrukturës rrugore përmes rikonstruktimit të dy rrugëve ekzistuese, dhe përmirësimi i infrastrukturës turistike përmes ndërtimit të rrugicave dhe rregullimit të hapësirave. Partnerë në projekt janë katër komuna Vevçani, Ohri, Makedonski Brod dhe Qendër Zhupë, ndërsa aktivitetet projektuese janë përkrahur financiarisht përmes Programeve për zhvillim të barabartë rajonal për vitin 2019 të Ministrisë për vetëqeverisje lokale dhe Byrosë për zhvillim rajonal.

Në kuadër të projektit janë realizuar aktivitetet vijuese: Koordinimi dhe menaxhimi i projektit; Përzgjedhja e konsulentëve për specifikim teknik dhe vlerësim të ofertave; Furnizime publike (2); Rikonstruktimi i rrugës Dimitra Vllahov (143 m) në Makedonski Brod; Rikonstruktimi i rrugës në vendbanimin Zhitineni (1400 m) në Qendër Zhupë; Ndërtimi i rrugicave të reja në vevçan (5 rrugica në gjatësi prej 630 m);

Deri në fund të vitit 2019 filloi por nuk përfundoi ndërtimi punëve arkitektonike në rrugën K.Abrash dhe sheshit Tabana në Ohër. Për shkak të disa kërkesave nga ana e Komunës së Ohrit për ndërtimin e disa aktiviteteve plotësuese për një kohë u ndaluan punimet për rikonstruktimin e rrugës Kosta Abrash dhe i sheshit të vogël rreth lokalitetit Tabana. Përkatësisht, Kryetari i Komunës, Konstantin Georgieski kërkoi që të përgatitet zgjidhje e re teknike për vendosjen e pajisjes urbane, ndriçim dhe të bëhet rregullimi i sheshit për çka Komuna e Ohrit do të investojë mjete financiare shtesë. Zyra projektuese e Komunës së Ohrit përgatiti zgjidhje adekuate teknike, dhe për ato shkaqe ka ndalesa në punë. Përveç asaj, ekzekutuesi i punëve, në dy raste, për shkak të vizitave të delegacioneve të larta të SHBA dhe Komisionit Evropian, kishte ndalesa disa ditore në kryerjen e punëve.

Komunat partnere në projekt në pjesën e kontributit vetanak siguruan organe mbikëqyrëse, dhe mjete financiare për punët shtesë të kërkuara.

Masa 1.5.1 Ndërtimi, rikonstruktimi dhe modernizimi i rrjetit rrugor

Treguesit

- Numri i aktiviteteve të realizuara
- Gjatësia e rrugëve, rrugicave të rikonstruktuar/ndërtuara

Rezultatet dalëse

- Përgatitja dhe realizimi i 2 furnizimeve publike ë veçanta për përzgjedhje të operatorëve ekonomik
- Përzgjedhja e konsulentëve dhe organeve mbikëqyrëse
- Raporte nga organi mbikëqyrës 3
- Vënia në shfrytëzim e objekteve 7
- Raporte të përgatitura 3
- Rrugë të rikonstruktuar në gjatësi prej 1.543 m në Makedonski Brod dhe Qendër Zhupë
- Ndërtimi i 5 rrugicave të reja në Vevçan në gjatësi prej 630 m

8. Ndërtimi dhe rikonstruktimi i rrugicave lokale në Vevçan

Projektin e realizon Komuna e Vevçanit me mjete nga programi për zhvillim rural për vitin 2018. Me Agjencinë për përkrahje financiare të bujqësisë dhe zhvillimit rural (APFBZHR) u nënshkrua Vendim për miratimin e kërkesës për përkrahje financiare gjatë mesit të muajit Qershor të vitit 2019. Në

pajtim me këtë Vendim Komuna e Vevçanit realizoi dy furnizime publike për realizimin e rrugicave lokale dhe për mbikëqyrje, deri në fund të vitit 2019. Dokumentacioni i furnizimit publik dhe Marrëveshjet me operatorët ekonomik u dorëzuan deri te Agjencia (APFBZHR) me qëllim që të merret vendimi përfundimtar dhe Marrëveshja për realizimin e aktiviteteve projektuese. Deri në fund të vitit 2019 aktivitetet ndërtimore në terren nuk filluan. Pritet që rikonstruktimi i katër rrugicave lokale në Vevçan me gjatësi të përgjithshme prej 315 m të realizohen gjatë vitit 2020.

Masa 1.5.1 Ndërtimi, rikonstruktimi dhe modernizimi i rrjetit rrugor

Treguesit

- Numri i aktiviteteve të realizuara

Rezultatet dalëse

- Përgatitja dhe realizimi 2 furnizimeve publike për realizim dhe mbikëqyrje
- 2 Marrëveshje të nënshkruara me operatorët ekonomik
- Marrëveshje e nënshkruar me APFBZHR

Qëllimi afatmesëm 2

Arsim i përshtatur për nevojat e zhvillimit ekonomik, mbrojtja sociale dhe shëndetësore, për popullsinë në rajon dhe krijimi i kushteve për parandalimin e migracionit

9. Përshtatja e objekteve me efikasitet energjetik në RPJP – shkolla

Projekti financohet përmes Programeve për zhvillim të barabartë rajonal të Ministrisë për vetëqeverisje lokale dhe Byrosë për zhvillim rajonal për vitin 2019. Qëllimi kryesor i projektit është zvogëlimi i shpenzimeve të energjisë elektrike dhe për ngrohje përmes ndërrimit të dritareve, dyerve, vendosjes së termo izolimit, vendosjes së elektrikes së re, rikonstruktimit të pullazit.

Rikonstruktimi i pullazit të sallës së sportit në SHF Penestia-Dibër – ndërrimi i konstruksionit të vjetër të dëmtuar 162,66 m²; dysheme e re në kulm 650,67 m²; vendosja e drurëve 1346,00 m²; hidro-izolim 667,11 m²; termo-izolim nga leshi i gurit – 500,62 m²; montimi i llamarinës së plastifikuar 667,11 m²; montimi i ollukëve horizontale dhe vertikale 187,6 m; furnizim dhe montim të FE ZN lentës 61,78 m.

Kryerja e punëve për rikonstruktimin e SHF në fshatin Mesheisht-Debërc- furnizimi i dritareve dhe dyerve të reja nga PVC 12; Lyerja e mureve 1165 m²; ndërtimi i dyshemesë; mure ndarëse 76,5 m²; plafonë të lëshuara 55,22; izolimi i tavaneve 305 m²; montimi i sistemit të ngrohjes; instalim elektrik, kanalizim;

Ndërrimi i dritareve në SHF Shën.Kirili i Ohrit - Ohër – ky aktivitet nuk është realizuar në tërësi deri në fund të vitit 2019. Përkatësisht, dy herë u anulua furnizimi publik për shkak se nuk ka pas asnjë ofertë adekuate. Për herë të tretë furnizimi publik u realizua me sukses dhe u nënshkrua marrëveshje me operatorin ekonomik. Kyçja në punë e operatorit u bë në fund të muajit dhjetor 2019, dhe afati i realizimit të aktiviteteve është shtyrë deri në fund të muajit maj 2020.

Gjatë zbatimit të aktiviteteve të përmendura, komunat partnere me kontributin e tyre e siguruan organin mbikëqyrës.

Masa 2.1.2 Krijimi i kushteve për hapjen e paraleleve për arsim profesional dhe institucioneve të arsimit të lartë në pajtim me nevojat e tregut të punës në të gjithë rajonin

Treguesit

- Numri i aktiviteteve të realizuara për ndërtim/rikonstruktiv të objekteve
- Hapësira dhe gjatësia e intervenimeve

Rezultatet dalëse

- Dokumentacion tenderi i përgatitur, u realizuan tre furnizime publike
- U përzgjedhën organet mbikëqyrëse nga ana e komunave dhe kyçja në punë
- Ndërimi i dritareve të vjetra me të reja nga PVC – 12 dritare dhe dyer
- U bë izolimi i tavanëve 305 m²
- U bë vendosja e izolimit termik 500 m²
- U krye elektrika e re për pjesën që adaptohet në kopsht në Mesheisht
- Ndërtimi kaldajës 57 m²
- Furnizimi dhe vendosja e sistemit për nxehje qendrore
- Ndërimi i konstruksionit të vjetër të dëmtuar 163 m²
- Montimi i llamarinës së plastifikuar në hapësirë prej 667 m²
- Rregullimi i strehës së kulmit në gjatësi prej 730 m
- Vendosja e pengesave për borë në gjatësi prej 215 m
- Montimi i ollukëve horizontal dhe vertikal 187 m

10. Qasje më e lehtë për shërbime të shpejta komunale dhe kyçje e qytetarëve në Komunën e Ohrit

Projektin e realizoi Komuna e Ohrit me përkrahje financiare nga Ambasada e Zvicrës dhe UNDP. Është bërë rikonstruktivi i shkallëve që të dërgojnë deri te salla e madhe e komunës së Ohrit, dhe është vendosur lift platformë për personat invalid. Është përshtatur hapësirë tek salla për personat me karroca invaliditeti, dhe janë vendosur rrugica taktile për personat e verbër. Gjithashtu tek salla janë ndërruar dritaret, është vendosur ndriçim i ri, nxehje, mobilie dhe pulte për personat me nevoja të veçanta.

Masa 2.2.3 Rritja e ndërgjegjes për barazi gjinore dhe nevoja për t'u kyçur në tregun e punës e gruas dhe grupeve nga kategoritë e rrezikuara

Treguesit

- Numri i aktiviteteve të realizuara për ndërtim/rikonstruktiv të objekteve

Rezultatet dalëse

- Dokumentacion tenderik i përgatitur, janë realizuar 2 furnizime publike
- U përzgjedh organ mbikëqyrës
- Ndërimi i PVC dritareve të vjetra me të reja në sallën e madhe
- Shkallë të ri konstruktura dhe vendosja e lift platformës për karrocet e invaliditetit
- Vendosja e rrugicës taktile për personat e verbër
- U vendos nxehje dhe ndriçim i ri

11. Përshtatja e objekteve me efikasitet energjetik në RPJP – kopshtet e fëmijëve

Projekti financohet përmes Programeve për zhvillim të barabartë rajonal të Ministrisë për vetëqeverisje lokale dhe Byrosë për zhvillim rajonal për vitin 2019. Qëllimi kryesor i projektit është

zvogëlimi i shpenzimeve të energjisë elektrike dhe për ngrohje përmes ndërrimit të dritareve, dyerve, vendosja e termo izolimit, fasadë e re termike rikonstruktimi i pullazit.

Kryerja e punëve për rikonstruktimin e objektit IPKF “8 Marsi” - Strugë – ndërrimi i dyerve dhe dritareve të vjetra – 2 dyer dhe 35 dritare; parapetet e dritareve 77,46 m; punimi i termo fasadës 450 m²; punimi i bazamentit 45 m²; montimi i ollukëve horizontal dhe vertikal (horizontal=145m, vertikal=38m); ndërrimi i konstruksionit të dëmtuar 395 m²; montimi i leshit të qelqit në gjithë pullazin 684 m²; furnizimi dhe montimi i qeramidheve të reja 158 m²; furnizimi dhe montimi i llamarinës në streha 684 m²; montimi i llamarinës së plastifikuar në pullaz 30 m²;

Kryerja e punëve në IPKF “Ollga Miceska” - Kërçovë – ndërrimi i dritareve dhe dyerve të vjetra – furnizimi dhe montimi i dyerve të reja -8 copë; furnizimi dhe montimi i dyerve me dritare- 12 copë; furnizimi dhe montimi i dritareve të reja- 39 copë; montimi i parapeteve të dritareve nga ana e jashtme- 143, m; montimi i parapeteve nga ana e brendshme nga PVC- 141,2 m.

Masa 2.3.2 Përmirësimi i përfshirjes së fëmijëve të moshës parashkollore në kopshte, veçanërisht në zonat rurale

Treguesit

- Numri i aktiviteteve të realizuara për ndërtimin/rikonstruktimin e objekteve
- Hapësira dhe gjatësia e intervenimit

Rezultatet dalëse

- Dokumentacioni tenderik i përgatitur, u realizuan 2 furnizime publike
- U përzgjedh organi mbikëqyrës nga ana e komunës
- Ndërrimi i dyerve dhe dritareve të vjetra -10 dyer, 12 dyer me dritare, 74 dritare
- Montimi i parapeteve nga jashtë dhe brenda 362 m
- Punimi i termo fasadës 450 m²
- Rikonstruktimi i pullazit – ndërrimi i konstruksionit të dëmtuar 395 m², montimi i leshit të qelqit 684 m²; qeramidhe të reja 158 m²

Qëllimi afatmesëm 3

Zhvillimi i turizmit i ndërlidhur me trashëgiminë kulturore dhe natyrore në rajonin planor

12. Rregullimi i zonave dhe rrugëve atraktive në rajonin planor Jugperëndimor

Projekti financohet përmes Shemës së granteve për projekte investuese që është pjesë e projektit “Zhvillim i barabartë rajonal i qëndrueshëm dhe inkluziv”, financuar nga Agjencia zvicerane për zhvillim dhe bashkëpunim dhe Ministrisë për vetëqeverisje lokale. Qëllimi kryesor i projektit është të pasurohet oferta turistike përmes ndërtimit të rrugëve për këmbësorë dhe rregullimi i zonave atraktive të cilat dërgojnë deri te lokalitetet natyrore, kulturore, arkeologjike, dhe vlerat turistike në zonat urbane dhe rurale, dhe me atë të rritet numri i turistëve dhe koha e bujtjeve në rajonin Jugperëndimor. U ndërtuan rrugë për këmbësorë në tri lokacione në tri komuna Ohër, Strugë dhe Debërc.

Në Ohër u ndërtua rruga për këmbësorë në pjesën e vjetër të qytetit nga Sahat kulla deri te Gorna porta në gjatësi prej 420 m dhe gjerësi prej 1,2m. Rruga është ndërtuar nga guri natyror dhe në gjatësinë e saj janë vendosur 20 kandelabra me drita në formë të fenerit që e paraqet arhitekturën e vjetër të Ohrit.

Rruga nga Struga deri në Kalisht është në gjatësi prej 1497 m dhe në gjerësi mesatare prej 2,3 m. Për ndërtimin e rrugës u kryen punë në pastrimin e terrenit nga degë dhe vegjetacion të egër, pastaj u shtrua shtresa e rërës, rrjetë, beton dhe gur natyror i cili është i mbushur me çimento. Kjo rrugë është vazhdimësi e rrugës së ndërtuar para dhjetëra vitesh nga ana e Komunës së Strugës në gjatësi prej 1 km. Me vazhdimin dhe me ndërtimin e të resë praktikisht qytetarët dhe turistët kanë 2,5 km rrugë për rekreacion në bregun e Liqenit të Ohrit.

U ndërtua rrugë me gur natyror në gjatësi prej 270 m dhe gjerësi prej 1 m përreth liqenit të Sllatinës në Debërc. Përveç rrugës është rregulluar edhe ambienti në afërsi të branës së rikonstruktuar, me çka janë vendosur 3 tavolina me karrige, shporta për mbeturina, karrige, parking për biçikleta dhe për vetura, dhe u vendos tabelë informative nga druri.

Masa 3.1.3 Sigurimi i infrastrukturës deri te atraksionet dhe pajisja e tyre

Trequesit

- Numri i aktiviteteve të realizuara

Rezultatet dalëse

- U realizua furnizim publik i ndarë 2 herë
- U nënshkruan 3 marrëveshje me operatorët ekonomik
- U ndërtua rruga për këmbësorë nga Sahat kulla deri në Gorna porta 420 m gjatësi dhe 1,2 m gjerësi
- U vendosën 20 kandelabra përgjatë rrugës në Ohër
- U ndërtua rruga për këmbësorë nga Struga deri në Kalisht në gjatësi prej 1497 m dhe gjerësi prej 2,2 m
- U ndërtua rrugë për këmbësorë përreth liqenit të Sllatinës në gjatësi prej 70 m dhe gjerësi 1 m
- U vendosën 3 tavolina me karrige përreth liqenit të Sllatinës, 1 tabelë informative, 1 parking me hapësirë prej 240 m², karrige dhe tavolina 5 shporta për mbeturina

13. Vizuelizimi i atraksioneve turistike në rajonin planor Jugperëndimor

Projekti “Vizuelizimi i atraksioneve turistike në rajonin planor JUGPERËNDIMOR” financohet përmes Shemës së granteve për Projekte inovative që është pjesë e projektit “Zhvillim i barabartë rajonal i qëndrueshëm dhe inkluziv” i cili financohet nga Agjencia zvicerane për zhvillim dhe bashkëpunim dhe Ministria e vetëqeverisjes lokale. Përkatësisht, në realizimin e këtij projekti së pari u përgatitën dhe u realizuan 2 furnizime publike: njëra për furnizimin e harduerit- katër info touch panele, dhe e dyta për përgatitjen e zgjidhjes softuerike për prezantimin e vlerave turistike në Vevçan, Dibër, Debërc dhe Makedonski Brod.

Ekipi i Qendrës për zhvillim të rajonit planor JUGPERËNDIMOR në bashkëpunim me komunat i përcaktoi atraksionet turistike në katër komunat, si dhe modulet e tjera (si bujtja, ushqimi, transporti, rekreacioni dhe koha) që janë të përfshira në prezantimet me qëllim që të mundësohet qëndrimi dhe lëvizja më e lehtë e turistëve në komunat. Në atë kontekst, pastaj u qas drejt përgatitjes së teksteve dhe fotografive për përmbajtjet e caktuara, dhe u bë edhe dizajni i zgjidhjes softuerike.

Këto aktivitete zgjatën deri në fund të muajit tetor, me çka punohej edhe për përkthimin e materialeve në gjuhën Angleze dhe Shqipe (për Dibrën), dhe lektorimi dhe korrigjimi adekuat i tyre. Gjithashtu, në bashkëpunim me komunat u përcaktuan edhe lokacionet se ku do të vendosen info touch panelet, për çka duhej të sigurohej kyçja në energji elektrike, si dhe Internet. Gjatë dhjetë ditëve të para të dhjetorit të vitit 2019 panelet informative arritën në Rajon, me çka u montuan dhe u vendosën në punë në lokacionet vijuese: Në Vevçan dhe Debërc në objektet e komunave, në Dibër në oborrin e ndërtesës së komunës, dhe në Makedonski Brod në bulevardin Marshali Tito. Në mesin

e muajit dhjetor u bë instalimin i zgjidhjes softuerike, me çka u bë testimi i zgjidhjeve harduerike dhe aplikative. Pra përfundimit të vitit kalendarik këto pajisje moderne u lëshuan në përdorim.

Masa 3.1.4 Sigurimi i informacioneve, sinjalizimit dhe vizuelizimit të atraksioneve turistike

Treguesit

- Numri i aktiviteteve të realizuara

Rezultatet dalëse

- U realizuan 2 furnizime publike
- U bë mapimi i atraksioneve turistike në 4 komuna
- U përgatitën tekste dhe fotografi për 100 atraksione në 4 komuna të rajonit
- Prezantimet e komunave janë bërë në gjuhën Maqedone dhe Angleze, ndërsa për Dibrën edhe në gjuhën Shqipe
- U furnizuan dhe u instaluan 4 panele informative
- U përgatit zgjidhja softuerike për prezantimin e gjithsej 100 atraksioneve turistike në katër komunat Vevçan, Dibër, Debërc dhe Makedonski Brod

Qëllimi afatmesëm 4

Mbrojtja e kualitetit të ambientit jetësor

14. Ndërtimi i stacionit pastrues në Vevçan

Këtë projekt e realizoi komuna e Vevçanit me mjete nga UNDP përmes Programit për përmirësimi e menaxhimit të krahinave të mbrojtura. Përkatesisht, gjatë vitit 2019 janë realizuar furnizime publike, u nënshkrua marrëveshje me operatorin ekonomik, dhe ka filluar ndërtimi i stacionit pastrues. Deri në fund të vitit 2019 80% e punëve në stacionin pastrues kanë përfunduar.

Masa 4.1.3 Sistemet e bartjes së ujërave të zeza komunale dhe stacionet e pastrimit

Treguesit

- Numri i aktiviteteve

Rezultatet dalëse

- Përgatitja e furnizimit publik dhe vlerësimi i tregut
- Furnizim publik i realizuar për furnizim të punëve dhe stoqeve
- Marrëveshje e nënshkruar me operatorin ekonomik
- Është ndërtuar 80% nga stacioni pastrues

15. Studim fizibiliteti për zgjidhjen e problemit me qentë endacak

Projektin e koordinonte zyra e UNDP në Shkup dhe i njëjti financohet me mjete të siguruar nga BE dhe UNDP. Specifikacioni teknik, furnizimin publik dhe marrëveshjen me operatorin ekonomik e nënshkroi zyra e UNDP në Shkup. Studimin e fizibilitetit e përgatiti kompania amerikane NAVANTI në bashkëpunim me ekspertë të vendit. Janë bërë të gjitha testimet në terren, është ndjekur numri i qenve endacak në zonat urbane në rajonin Jugperëndimor. Me studimin është bërë analizë e gjendjes aktuale dhe janë propozuar zgjidhje për këtë problem përmes propozim modeleve për menaxhim me qentë endacak. Për rajonin planor Jugperëndimor planifikohet ndërtimi i 2 stacionarëve nga të cilat 1 në Kërçovë dhe një në Ohër. Gjithashtu për këto dy stacionarë janë bërë projekte ideore të cilat deri në fund të vitit 2019 ishin në fazë të revidimit.

Masa 4.2.1 Mbrojtja e biodiversitetit

Treguesit

- Numri i aktiviteteve të realizuara

Rezultatet dalëse

- Furnizim publik i realizuar, operatori ekonomik i përzgjedhur, marrëveshje e nënshkruar
- Analiza e kuadrit ligjor
- Analiza në terren, matja e numrit të qenve endacak në qendrat urbane
- Studim fizibiliteti i përgatitur për zgjidhjen e problemit me qentë endacak
- U përgatitën 2 projekte ideore për 2 stacionarë për qentë endacak në Ohër dhe Kërçovë

16. Përshtatja e objekteve me efikasitet energjetik në RPJP

Projekti financohet përmes Programeve për zhvillim të barabartë rajonal të Ministrisë për vetëqeverisje lokale dhe Byrosë për zhvillim rajonal për vitin 2019. Qëllimi kryesor i projektit është ulja e shpenzimeve për energji elektrike dhe për ngrohje përmes ndërrimit të dritareve, dyerve, vendosjes së hidro izolimit, vendosjes së termo izolimit, vendosja e termo fasadës, rikonstruktimi i pullazit dhe mbulimi i pullazit në një objekt publik në rajon.

Komuna e Vevçanit – Rikonstruktimi i dyerve dhe dritareve në Shtëpinë e Kulturës – ndërrimi i dyerve dhe dritareve të vjetra, furnizimi dhe montimi i dyerve të reja- 6 copë; furnizimi dhe montimi i dritareve të reja 63 copë; rregullimi i parapeteve nga ana e brendshme- 88m; rregullimi i parapeteve nga ana e jashtme- 88 m;

Komuna e Qendër Zhupës – Rikonstruktimi i ndërtesës së vjetër administrative të Qendër Zhupës – furnizimi dhe montimi i dyerve të brendshme- 9 copë; furnizimi dhe montimi i dritareve nga PVC- 23 copë; furnizimi dhe montimi i dyerve PVC të jashtme- 2 copë; lyerje me malter të mureve të brendshme- 448 m²; punimi i demit fasadës 624 m²; përgatitja e konstruksionit të pullazit 174,4 m²; vendosja e binarëve nga druri 1250 m; vendosja e mbulesës së pullazit nga llamarina e plastifikuar 284 m²; punë elektro instaluese.

Masa 4.2.2 Kualiteti i ajrit

Treguesit

- Numri i aktiviteteve të realizuara për ndërtim/rikonstruktim të objekteve, hapësirave, gjatësi

Rezultatet dalëse

- Dokumentacion tenderik i përgatitur, të realizuara 2 furnizime publike
- U përzgjedhën organet mbikëqyrëse nga ana e komunave dhe fillimi me punë
- Ndërtimi i konstruksionit të pullazit 174,4 m², vendosja e binarëve të drurit 1250 m,
- Vendosja e mbulesës së pullazit nga llamarina e plastifikuar 284 m²
- Përgatitja e demit fasadës 624 m²
- Vendosja e instalacionit elektrik, ujësjellës, kanalizim dhe saniteri
- Ndërrimi i dyerve dhe dritareve të vjetra me PVC – 17 dyer, 86 dritare
- Lyerja e hapjeve rreth dyerve dhe dritareve nga brenda dhe jashtë 176m
- Lyerje me malter e mureve të brendshme 448 m²

Nga shuma e përgjithshme e aktiviteteve në këtë sferë konstatohet se 125 janë të ndërlidhura me realizimin e qëllimit të parë afatmesëm nga Programi për zhvillim të rajonit planor, me qëllimin afatmesëm të dytë janë të ndërlidhura 48 aktivitete, me qëllimin afatmesëm të tretë 142 aktivitete, dhe me të katërtin 34 aktivitete nga Programi për zhvillim.

Duke i përmbledhur të gjithë aktivitetet duhet të theksohet se janë realizuar gjithsej 349 aktivitete në të katër qëllimet afatmesme nga programi për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor.

PASQYRË TABELARE E AKTIVITETEVE TË REALIZUARA NË VITIN 2019 DHE LIDHJA E TYRE ME PROGRAMIN PËR ZHVILLIM TË RAJONIT PLANOR JUGPERËNDIMOR

Qëllimi afatmesëm	Masa	Lloji i aktivitetit	Numri i aktiviteteve
<u>I.ZHVILLIMI EKONOMIK</u>			
PRIORITETI			
1.1 Rritja e konkurrencës së ekonomisë rajonale	1.1.1 Lidhja e institucioneve arsimore dhe kërkimore		
	1.1.2 Rritja e kapaciteteve për inovacion të ndërmarrjeve	Punëtori konsultative, takime, përgatitja e koncepteve dhe aplikacioneve të plota	10
	1.1.3 Rritja e kapaciteteve për fondet adekuate të shtetit dhe BE-së	Furnizime publike, Konferencë rajonale, prezantime, Përmbledhje, forume, takime, koncepte, aplikacione, Plane të integruara, PALE, furnizimi i pajisjeve	42
	1.1.4 Përfitimet për investime në TIK		
	1.1.5 Brendimi i Rajonit dhe produkteve kryesore		
1.2 Tërheqja e investimeve	1.2.1 Mapimi i potencialeve të rajonit për investime		
	1.2.2 Promovimi i potencialeve ekonomike		
1.3 Përficimi i sektorit të NVM	1.3.1 Përforcimi i kapaciteteve të NVM		
	1.3.2 Mbështetje për start-up biznese		
	1.3.3 Shfrytëzimi i programeve për financim të NVM	Takime pune, baza të azhurnuara, raporte, anketa, analiza	22
1.4 Bujqësia dhe zhvillimi rural	1.3.4 Lehtësime për zanatet tradicionale		
	1.3.5 Mbështetje për përfaqësim të përbashkët të kompanive		
1.5 Zhvillimi i infrastrukturës transportuese dhe komunikuese	1.4.1 Përmirësimi i		

	<i>cilësisë dhe ofertës të produkteve bujqësore</i>		
	<i>1.4.2 Krijimi i kushteve për zhvillim rural</i>	Takime pune, specifikime, furnizime publike, marrëveshje	11
	<i>1.5.1 Ndërtimi dhe modernizimi i rrjetit rrugor</i>	Furnizime publike, përgatitja e projekteve themelore dhe infrastrukturore, rikonstruktimi dhe ndërtimi i rrugëve, raporte	40
	<i>1.5.2 Aplikimi i TIK</i>		
			125
Qëllimi afatmesëm	Masa	Lloji i aktivitetit	Numri i aktiviteteve
II.ARSIMI DHE ZHVILLIMI SOCIAL PRIORITETET 2.1 Arsim cilësor 2.2 Përfshirja në tregun e punës të grupeve të rrezikuara 2.3 Programe sociale	<i>2.1.1 Promovimi i përparësive të AMP</i>		
	<i>2.1.2 Krijimi i kushteve për paralele për AMP</i>	Furnizime publike, ndërrimi i dritareve, vendosja e izolimit, ndërtimi i kaldajës, instalimi i sistemit për nxehje, ndërrimi i kulmit, vendosja e ollukëve	22
	<i>2.1.3 Promovimi i biznesmenëve të suksesshëm</i>		
	<i>2.2.1 Inicijativa për zona rurale</i>		

	2.2.2 Përfshirja e kuadrit profesional në planifikim		
	2.2.3 Barazi gjinore dhe përfshirje të grupeve të rrezikuara në tregun e punës	Furnizime publike, ndërrimi i dritareve, rikonstruktimi i shkallëve, vendosja e ndriçimit dhe nxehjes	11
	2.3.1 Rritja e përfshirjes së mbrojtjes sociale		
	2.3.2 Përfshirja e fëmijëve në kopshte në zonat rurale	Furnizime publike, ndërrimi i dritareve, termo-fasadë, rikonstruktimi i pullazit	15
	2.3.3 Programe për mbrojtjen e personave të moshuar, rrjet për mbrojtje shëndetësore		
			48
Qëllimi afatmesëm	Masa	Lloji i aktivitetit	Numri i aktiviteteve
III.ZHVILLIMI I TURIZMIT PRIORITETET 3.1 Zhvillimi i infrastrukturës	3.1.1 Përgatitja e dokumentacionit urbanistik planor		
	3.1.2 Shtigje malore dhe rrjetëzim me rajonet e tjera		
	3.1.3 Sigurimi i infrastrukturës deri te atraksionet dhe pajisja e tyre	Furnizime publike, ndërtimi i rrugëve, rregullimi i hapësirave, vendosja e dritave, vendosja e pajisjeve urbane (pushimore, karrige, tavolina, shporta, tabela informative)	17

3.2 Përforcimi i kapaciteteve për zhvillim të turizmit	3.1.4 <i>Info, sinjalizim dhe vizuelizim të atraksioneve turistike</i>	Furnizime publike, mapimi, përgatitja e tekstit dhe fotografive, prezantime, përkthime, harduer, softuer	125
	3.1.5 <i>Revitalizim dhe ndërtim i objekteve në zonat rurale</i>		
	3.1.6 <i>Ndërtimi, rivitalizimi i shtëpive malore</i>		
	3.2.1 <i>Sistem për organizim turistik të rajonit</i>		
	3.2.2 <i>Trajnime për ngritjen e kapaciteteve</i>		
	3.2.3 <i>Përmirësimi i punës së klasterëve dhe shoqatave</i>		
	3.2.4 <i>Vendosja e sistemit për evidentimin e turistëve</i>		
	3.2.5 <i>Krijimi i klimës për PPP</i>		
	3.2.6 <i>Sistem për menaxhim të destinacioneve</i>		
	3.3.1 <i>Azhurnimi i hartave turistike</i>		
3.3 Krijimi i ofertës turistike rajonale	3.3.2 <i>Brendimi i rajonit</i>		
	3.3.3 <i>Prodhime turistike mikse</i>		
	3.3.4 <i>Zhvillimi i ofertës gastronomike</i>		
	3.3.5 <i>Prodhime nga turizmi kulturor</i>		
	3.3.6 <i>Rritja e konkurrencës</i>		
	3.3.7 <i>Promovimi i vlerave turistike</i>		
Qëllimi afatmesëm	Masa	Lloji i aktivitetit	Numri i aktiviteteve
<u>IV.RUAJTJA E</u>	4.1.1		

<p>KUALITETIT TË AMBIENTIT JETËSOR</p> <p>PRIORITETI</p> <p>4.1 Ndërtimi, rikonstruktimi dhe modernizimi i infrastrukturës komunale</p>	<p><i>Rikonstruktimi dhe modernizimi i sistemeve për ujësjellës</i></p>		
<p>4.1 Ndërtimi, rikonstruktimi dhe modernizimi i infrastrukturës komunale</p>	<p><i>4.1.2 Sistem i integruar për menaxhim me mbeturinat e ngurta</i></p>		
	<p><i>4.1.3 Sisteme për ujërat e zeza komunale</i></p>	<p>Furnizime publike, marrëveshje, Ndërti i SPUZ</p>	<p>6</p>
<p>4.2 Mbrojtja e biodiversitetit, ajrit, ujit dhe tokës</p>	<p><i>4.2.1 Mbrojtja e biodiversitetit</i></p>	<p>Furnizime publike, analiza e kornizës ligjore, matje dhe analiza në terren, studim fizibiliteti projekte ideore për stacionarë</p>	<p>10</p>
	<p><i>4.2.2 Kualiteti i ajrit</i></p>	<p>Furnizime publike, rikonstruktim të pullazit, lysterje me malter, ndërrim të dritareve, fasadë termike, instalime ujësjellës dhe rryme</p>	<p>18</p>
	<p><i>4.2.3 Mbrojtja e ujit dhe tokës</i></p>		
			<p>34</p>
<p>GJITHSEJ AKTIVITETE TË REALIZUARA</p>			<p>349</p>